

Banka NBG Albania Sh.A.

**Raporti i auditorit të pavarur dhe
pasqyrat financiare
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015**

TABELA PËRMBLEDHËSE

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË	4
1. Informacion i përgjithshëm	5
2. Deklarata e përpueshmërisë dhe baza e përgatitjes së pasqyrave financiare	5
3. Përmbledhje e parimeve bazë kontabël	5
4. Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore	11
5. Hua dhe paradhënie për institucionet e kreditit, neto	11
7. Letra me vlerë të vendosjes	14
8. Letra me vlerë të mbajtura për tregtim	14
9. Aktive të patrupëzuara, neto	15
10. Aktive të trupëzuara, neto	16
11. Aktive të tjera	16
12. Detyrime ndaj institucioneve të kreditit	17
13. Detyrime ndaj klientëve	17
14. Provigjone për kreditë standarte dhe në ndjekje	20
15. Detyrime të tjera	20
16. Borxhi i varur	20
17. Kapitali aksionar	21
17.1 Rezerva ligjore	22
17.2 Kapitali i paguar në natyrë (Fondi i dhuruar)	22
17.3 Rezerva e rivlerësimit	22
18. Të ardhura nga interesi	22
19. Shpenzime interesi	23
20. Të ardhura nga komisione dhe tarifa	23
21. Fitimi nga rivlerësimi i valutave, neto	23
22. Shpenzime administrative	23
23. Shpenzime personeli	24
24. Primi i sigurimit për depozitat e klientëve	24
25. Provigjone për humbjet nga huatë	24
26. Tatimi mbi fitimin	25
27. Detyrime dhe angazhime që përfshijnë zërat jashtë pasqyrës së bilancit	25
28. Ngjarje pas datës së bilancit	26
29. Administrimi i rrezikut financiar	26
30. Mjaftueshmëria e kapitalit	33
31. Transaksionet me palët e lidhura	33



Ernst & Young Certified Auditors
Albania Branch
NIUS: K619110121
Ibrahim Rugova Str, Sky
Tower, 6th floor
1001, Tirana, Albania

Tel: +35542419575
Fax: +35542419570
ey.com

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Drejtuesve të Bankës NBG Albania sh.a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur të Bankës NBG Albania sh.a. ("Banka"), të cilat përfshijnë bilancin më 31 Dhjetor 2015, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, të ndryshimeve në kapitalin aksionar, të fluksit të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Nenin 47 të Ligjit Për Bankat në Republikën e Shqipërisë (Ligji Nr. 9662 datë 18 Dhjetor 2006) dhe Metodologjinë e Raportimit dhe Përmbajtjes së Raportimit Financiar aprovuar nga Banka e Shqipërisë më 24 Dhjetor 2008, dhe për ato kontrole të brendshme, të cilat drejtimi i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimeve.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është që, duke u bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne t'u përmbahemi kërkesave etike të përshtatshme, dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të fituar siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë që mbështet tepricat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura janë në varësi të gjykimit tonë, përfshirë këtu vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, prej mashtrimit apo gabimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne shqyrtojmë kontrollin e brendshëm i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por që nuk kanë për qëllim shprehjen e një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe të çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë një bazë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionin tonë.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të NBG Albania sh.a., më datë 31 dhjetor 2015, janë përgatitur, në të gjithë aspektet materiale, në përputhje me Nenin 47 të Ligjit mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë (Ligji Nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006) dhe Metodologjinë e Raportimit dhe Përmbajtjes së Raportimit Financiar aprovuar nga Banka e Shqipërisë më 24 dhjetor 2008.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri

Tiranë, Shqipëri
25 shkurt 2016


Mario Vangjel

Eskpert Kontabël i Regjistruar

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
MË 31 DHJETOR 2015

	Shënime	31 Dhjetor 2015 në '000 lekë	31 Dhjetor 2014 në '000 lekë
AKTIVET			
Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore	4	3,797,522	5,283,022
Hua dhe paradhënie për institucionet e kreditit, neto	5	3,845,372	6,199,170
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	6	21,119,001	18,840,687
Letra me vlerë të vendosjes	7	5,168,815	8,448,925
Letra me vlerë të mbajtura për tregtim	8	-	51,037
Aktive të patrupëzuara, neto	9	55,938	37,610
Aktive të trupëzuara, neto	10	99,325	110,728
Aktive të tjera	11	303,191	532,631
TOTALI I AKTIVEVE		34,389,164	39,503,810
DETYRIMET			
Detyrime ndaj institucioneve të kreditit	12	2,307,402	1,186,022
Detyrime ndaj klientëve	13	26,494,875	33,057,422
Provizione për kreditë standarde dhe në ndjekje	14	359,243	337,545
Detyrime të tjera	15	353,843	543,121
Borxhi i varur	16	1,647,623	1,681,958
Totali i detyrimeve		31,162,986	36,806,068
KAPITALI AKSIONAR			
Kapitali i paguar	17	7,235,533	7,235,533
Fondi i dhuruar	17	352,381	352,381
Rezerva e rivlerësimit	17	335,218	411,117
Rezerva ligjore	17	444,196	415,755
Humbje të akumuluar	17	(5,141,150)	(5,717,044)
Totali i kapitalit aksionar		3,226,178	2,697,742
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT AKSIONAR		34,389,164	39,503,810

Pasqyrat financiare të Bankës u autorizuan nga Drejtimi më 25 shkurt 2016 dhe u nënshkruan për Bankën nga:


Ioannis AGATHOS
Drejtor Ekzekutiv


Brunilda PAPA (JAKOVI)
Drejtoresh e Operacioneve

Shënimet shoqëruese në faqet 5 – 34 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2015 në '000 lekë	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2014 në '000 lekë
Të ardhura nga interesi	18	1,741,856	1,953,667
Shpenzime interesi	19	(418,294)	(842,903)
Të ardhura nga interesi, neto		1,323,562	1,110,764
Të ardhura nga komisione dhe tarifa	20	269,384	254,238
Shpenzime për komisione dhe tarifa		(6,850)	(8,048)
Të ardhura nga komisione dhe tarifa, neto		262,534	246,190
Fitimi nga rivlerësimi i valutave, neto	21	34,226	42,565
Të ardhura/shpenzime të tjera, neto		41,133	8,912
Të ardhura operative		75,359	51,477
Shpenzime administrative	22	(473,827)	(453,270)
Shpenzime personeli	23	(436,406)	(430,463)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	9, 10	(65,058)	(65,945)
Primi i sigurimit për depozitat e klientëve	24	(87,122)	(95,806)
Shpenzime operative		(1,062,413)	(1,045,484)
Provigjone për humbjet nga huatë	25	29,462	(176,763)
Fitimi neto para tatimit		628,504	186,184
Tatim mbi fitimin	26	(45,204)	(53,692)
Fitimi neto për vitin		583,300	132,492

Shënimet shoqëruese në faqet 5 – 34 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**

	Kapitali i paguar në '000 lekë	Kapital i paguar i paregjistruar në '000 lekë	Fond i dhuruar në '000 lekë	Rezerva e rivlerësimit në '000 lekë	Rezerva ligjore në '000 lekë	Humbje të akumuluar në '000 lekë	Totali në '000 lekë
Gjëndja më 31 Dhjetor 2013	7,235,533	-	352,381	325,238	449,649	(5,845,318)	2,517,483
Lëvizje në rezervën e rivlerësimit	-	-	-	85,879	-	-	85,879
Rritja e rezervës ligjore	-	-	-	-	4,218	(4,218)	-
Fitimi neto për vitin	-	-	-	-	-	132,492	132,492
Efekti negativ nga rënia në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vendosjes	-	-	-	-	(38,112)	-	(38,112)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2014	7,235,533	-	352,381	411,117	415,755	(5,717,044)	2,697,742
Lëvizje në rezervën e rivlerësimit	-	-	-	(75,899)	-	-	(75,899)
Rritja e rezervës ligjore	-	-	-	-	7,406	(7,406)	-
Fitimi neto për vitin	-	-	-	-	-	583,300	583,300
Efekti negativ nga renia në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vendosjes	-	-	-	-	21,035	-	21,035
Gjëndja më 31 Dhjetor 2015	7,235,533	-	352,381	335,218	444,196	(5,141,150)	3,226,178

Shënimet shoqëruese në faqet 5 – 34 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**

Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2015 në '000 lekë	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2014 në '000 lekë
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operacionale		
Humbja neto para tatimit për vitin	628,504	186,184
Rregullime për të rakorduar ndryshimet në aktivet neto me rrjedhjen neto të parasë nga aktivitetet operacionale:		
Amortizimi për aktivet e trupëzuara	10 38,797	41,657
Amortizimi për aktivet e patrupëzuara	9 14,038	12,174
Amortizimi për permirësimet e ambienteve të marra me qera	12,224	12,114
Provigjoni për humbjet nga huatë dhe të tjera	25 (17,462)	176,763
Diferencat nga rivlerësimi i kapitalit aksionar	17 (110,233)	85,150
Rrjedhja e parasë nga operacionet përpara lëvizjeve në kapitalin punues	565,868	514,042
Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operacionale		
Pakësim / (rritje) në huatë dhe paradhëniet me institucionet e kreditit	5 2,353,798	150,120
Letra me vlerë të mbajtura për tregtim, neto	51,037	51,115
Pakësim në huatë dhe paradhëniet për klientët	6 (2,248,852)	769,196
Pakësim në aktivet e tjera	11 206,599	45,091
Rritje/(pakësim) në detyrimet ndaj institucioneve të kreditit	12 1,121,380	402,078
(Pakësim)/rritje në detyrimet ndaj klientëve	13 (6,562,547)	(565,236)
(Pakësim)/rritje në detyrimet e tjera	14, 15 (179,580)	(9,944)
Paraja e përdorur në operacione	(5,258,165)	842,420
Tatim mbi fitimin i paguar	26 (22,363)	(53,692)
Paraja neto e përdorur në operacione	(4,714,660)	787,999
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerjet e aktiveve të trupëzuara	10 (27,393)	(21,751)
Blerjet e aktiveve të patrupëzuara	9 (44,590)	(25,868)
Shitje në letra me vlerë të tregtimit	2,348,671	758,652
Letra me vlerë të maturuara	6,364,096	4,414,536
Blerjet në letra me vlerë të tregtimit	(5,411,623)	(6,076,312)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese	3,229,160	(950,743)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese		
Ndryshim në borxhin e varur	16 -	-
Rritje në kapitalin e paguar	-	-
Paraja neto (e përdorur)/e gjeneruar nga aktivitetet financuese	-	-
Rritja në para gjatë vitit	(1,485,500)	352,027
Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore më 1 Janar	5,283,022	4,930,995
Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore më 31 Dhjetor	3,797,522	5,283,022

Shënimet shoqëruese në faqet 5 – 34 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Banka NBG Albania sh.a. (“Banka”) është filial i Bankës Kombëtare të Greqisë e cila vepron në të gjithë fushat e aktivitetit bankar dhe veçanërisht në transaksionet tregtare duke përdorur një rrjet të gjerë korrespondentësh ndërkombëtarë.

Banka filloi aktivitetin e saj në fund të muajit Nëntor 1995 me një kapital të paguar prej 2,000,000 USD me ekuivalent 200,000 mijë LEK. Gjatë periudhës 1999 - 2013 kapitali i paguar është rritur dhe tani ka vlerën prej 7,587,914 mijë LEK. Rritja e fundit u bë në 23 nëntor 2012 me një vlerë prej 3,000,000 EUR me ekuivalent 419,310 mijë LEK.

Në maj të vitit 2012, Banka ka ndryshuar statusin e saj nga degë në filial të Bankës Kombëtare të Greqisë, një proces ky i monitoruar nga Banka e Shqipërisë, e cila aprovoi këtë transformim me aneksin e licences nr. 08/1 datë 25 maj 2012. Si pasojë, Banka ndryshoi emrin e saj në Banka NBG Albania sh.a. dhe formën ligjore në shoqëri aksionare me ortak të vetëm Bankën Kombëtare të Greqisë me kapital aksionar 7,168,604,546 LEK të ndarë në 55,851,664 aksione normale me vlerë nominale një EUR (ose 0.92 USD ose 128.35 LEK).

Banka operon me një rrjet prej 27 njësisish të vendosura në Tiranë, Durrës, Korçë, Vlorë, Lezhë, Elbasan, Gjirokastrë, Shkodër, Lushnjë, Pogradec, Berat, Sarandë, Fushë Krujë, Fier, Kukës, Bilisht dhe Kavajë. Në datën 31 Dhjetor 2015 Banka kishte 293 punonjës (31 Dhjetor 2014: 284 punonjës).

Drejtimi

Drejtor Ekzekutiv

Ioannis Agathos

Drejtor i Riskut

Ioannis Antoniadis

Drejtoreshë e Operacioneve

Brunilda Papa (Jakovi)

Drejtoreshë e Bankingut Individual

Aida Apostoli

Drejtor i Korporatave

Anastasios Asimakopoulos

2. Deklarata e përpueshmërisë dhe baza e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare të Bankës janë përgatitur në përputhje me “Metodologjinë e raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare” (“Metodologjia e Raportimit Financiar” ose “MRF”) e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 Dhjetor 2008. MRF u miratua për qëllime rregulatore, në zbatim të Nenit 47 të Ligjit nr. 9662, datë 18 Dhjetor 2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Të dhënat aktuale dhe ato krahasuese janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe.

Parimet kontabël të zbatuara nga Banka, janë të njëjta me ato të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014.

3. Përmbledhje e parimeve bazë kontabël

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në LEK sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj, të deklaruara me kosto historike, konvertohen sipas normës së këmbimit të fundvitit. Diferencat nga konvertimi paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, të deklaruara me kosto historike konvertohen sipas normës së këmbimit në datën e transaksionit.

3. Përmbledhje e parimeve bazë kontabël (vazhdim)**3.1 Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)**

Kurset e këmbimit (LEK kundrejt monedhave të huaja) për monedhat kryesore paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Dollari amerikan (USD)	125.79	115.23
Monedha e përbashkët europiane (EUR)	137.28	140.14
Paundi britanik (GBP)	186.59	179.48
Dollari kanadez (CAD)	90.53	99.55
Franga zviceriane (CHF)	126.74	116.52
Jeni japonez (JPY) (për 100 JPY)	104.50	96.49

Kapitali i paguar është trajtuar si një zë monetar dhe është rivlerësuar në përputhje me parimin e shpjeguar më sipër. Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, kapitali në monedhë të huaj duhet të paraqitet në bilanc i konvertuar me kursin e këmbimit në datën e transaksionit dhe një “rezervë rivlerësimi” e krijuar në kapitalin e aksionarëve që përfaqëson diferencën në Lek ndërmjet kursit të fundit të periudhës me kursin historik që përdoret për të regjistruar kapitalin e paguar në monedhë të huaj. Ndryshimi në rezervën e rivlerësimit midis vitit aktual dhe atij të mëparshëm pasqyrohet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

3.2 Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore

Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë dhe gjëndje të pakushtëzuara në bankat qëndrore, subjekt i një rreziku jo domethënës ndaj ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore mbahen në pasqyrën e bilancit të me kosto të amortizuar.

3.3 Depozita dhe llogaritë me bankat

Depozitat dhe llogaritë me bankat përfshijnë depozita ndërbankare dhe zëra që janë në procesin e arkëtimit.

3.4 Letra me vlerë të vendosjes

Letrat me vlerë të vendosjes paraqiten me vlerën e tregut, me interesin e përlllogaritur për kuponin e paguar. Çdo zbritje apo prim i paguar për vlerën nominale në momentin e transferimit përlllogaritet deri në ditën e pagesës së letrës me vlerë të vendosjes. Letrat me vlerë të vendosjes janë investime të cilat Banka i blen me qëllim mbajtjen e tyre për një periudhë më shumë se 6 muaj, me përjashtim të letrave me vlerë të cilat Banka ka për qëllim ti mbajë deri në maturim dhe të cilat plotësojnë kushtet e tjera të investimit të letrave me vlerë. Letra me vlerë të vendosjes përfshijnë gjithashtu investimet në letra me vlerë të cilat nuk klasifikohen si letra me vlerë të tregtueshme dhe as letra me vlerë të mbajtura deri në maturim. Letrat me vlerë të vendosjes pas rregjistrimit fillestar, maten me vlerë të drejtë. Fitimi apo humbja që rezulton nga ndryshimi i vlerës së drejtë të letrave me vlerë të vendosjes, paraqitet në pasqyrën përmbledhëse të ardhurave në periudhën në të cilën ndodh.

3. Përmbledhje e parimeve bazë kontabël (vazhdim)**3.5 Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim**

Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim përfshijnë Bonot e Thesarit. Investimet që kanë pagesa fikse ose të përcaktuara për të cilat Banka ka synimin e qartë dhe aftësinë për t'i mbajtur deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose si të vlefshme për shitje.

Investimet që mbahen deri në maturim paraqiten me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv, të pakësuar me humbjet e mundshme nga rënia në vlerë.

Çdo skonto ose prim i paguar mbi vlerën nominale në momentin e blerjes përlogaritet deri në datën e pagesës së principalit të letrës me vlerë.

3.6 Letra me vlerë të tregtueshme

Letrat me vlerë të tregtueshme do të konsiderohen si letra me vlerë të tregtueshme kur ato përftohen ose shiten që në fillim, me synimin për t'u rishitur ose riblerë për një periudhë afatshkurtër. Ato do të regjistrohen në llogaritë në datën e përfitimit dhe me çmimin e tyre të përfitimit, përfshi shpenzimet dhe çdo interes të përlogaritur.

3.7 Matja e vlerës reale

Meqënëse nuk ekziston tregu financiar për instrumentet financiare të krijuara në Shqipëri, vlera reale bazohet mbi gjykimet në lidhje me përvojën e humbjeve të pritshme në të ardhmen, kushtet aktuale ekonomike, karakteristikat e rrezikut të instrumenteve të ndryshme financiare dhe faktorëve të tjerë. Matja e vlerës reale bazohet në instrumentet financiare ekzistuese në bilanc, pa u përpjekur për të matur vlerën e parashikuar të biznesit në të ardhmen dhe vlerën e mjeteve e detyrimeve që nuk konsiderohen instrumente financiare. Mjetet dhe detyrimet që nuk konsiderohen instrumente financiare përfshijnë kryesisht: aktivet e qëndrueshme dhe depozitat

Vlera reale e instrumentave financiare më 31 dhjetor 2015 është si më poshtë:

	Vlera reale				Totali
	Vlera kontabël	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	
Hua dhe paradhënie për institucionet e kreditit	3,845,372	1,568,919	2,276,453	-	3,845,372
Letra me vlerë të tregtueshme	-	-	-	-	-
Letra me vlerë të vendosjes	5,168,815	-	5,168,815	-	5,168,815
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	21,119,001	-	-	21,119,001	21,119,001
Total aktive financiare	26,287,816	-	5,168,815	21,119,001	26,287,816
Detyrime ndaj klienteve	26,494,875	6,133,116	20,361,759	-	26,494,875
Detyrime ndaj institucioneve të kreditit	2,307,402	13,890	2,293,512	-	2,307,402
Borxhi i varur	1,647,623	-	1,647,623	-	1,647,623
Total detyrime financiare	30,449,900	6,147,006	24,302,894	-	30,449,900

BANKA NBG ALBANIA SH.A.**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015***(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, nëse nuk shprehet ndryshe)***3. Përmbledhje e parimeve bazë kontabël (vazhdim)****3.7 Matja e vlerës reale (vazhdim)**

Vlera reale e instrumentave financiare më 31 dhjetor 2014 është si më poshtë:

	Vlera reale				Totali
	Vlera kontabël	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	
Hua dhe paradhënie për institucionet e kreditit	6,199,170	1,227,674	4,971,496	-	6,199,170
Letra me vlerë të tregtueshme	51,037	-	51,037	-	51,037
Letra me vlerë të vendosjes	8,448,925	700,942	7,747,983	-	8,448,925
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	18,840,687	-	-	18,840,687	18,840,687
Total aktive financiare	27,340,649	700,942	7,799,020	18,840,687	27,340,649
Detyrime ndaj klienteve	33,057,422	8,362,911	24,694,511	-	33,057,422
Detyrime ndaj institucioneve të kreditit	1,186,022	19,761	1,166,261	-	1,186,022
Borxhi i varur	1,681,958	-	1,681,958	-	1,681,958
Total detyrime financiare	35,925,402	8,382,672	27,542,730	-	35,925,402

Për të matur vlerën reale për secilin grup instrumenti financiar deri më 31 dhjetor 2015 janë përdorur metoda dhe supozimet e mëposhtme:

Hua ndaj klientëve – Vlera reale e huase për klientë për të cilët është e vëzhgueshme në treg mund të matet duke përdorur Nivelin 2 të hierarkisë. Megjithatë, nëse përhapja e huasë së klientit nuk është e vëzhgueshme në treg vlera reale mund të matet duke përdorur Nivelin 3 të hierarkisë. Vlera reale e huasë do të përafrohet me vlerën kontabël sepse portofoli i kredisë është i përbërë kryesisht nga hua me interesa të luhatsëm të cilat rishikohen cdo 3 muaj.

Depozitat – Të gjitha llogaritë e depozitave pa afat duhet të maten duke u bazuar në Nivelin 1 të hierarkisë, duke qënë se ato mund të konvertohen lehtësisht në mjete monetare nëse kërkohen. Të gjitha depozitat e tjera (duke përfshirë depozitat me afat) duhet të klasifikohen në Nivelin 2 të hierarkisë së vlerës reale. Kohëzgjatja mesatare e depozitave është më pak se 1 vit (afërsisht 6 muaj) duke bërë që vlera reale të jetë e përafërt me vlerën kontabël.

Hua ndaj institucioneve të kreditit – Të gjitha depozitat e kursimeve maten duke u bazuar në Nivelin 1 të hierarkisë, ndërsa të gjitha depozitat e tjera maten duke u bazuar në Nivelin 2 të hierarkisë.

Borxhi i varur – Borxhi i varur ka norma interesi të luhatshme të cilat rishikohen cdo tre muaj. Norma e interesit është e përbërë nga Euribor plus një marzh. Për më tepër, borxhi i varur është ndaj Grupit dhe është e vështirë të gjendet vlerësime të krahasueshme në treg për llogaritjen e vlerës reale.

Nëse një ose disa instrumenta financiare mbahen në një vlerë më të madhe vlera e tij reale, duhet të paraqiten arsyet se përse nuk është zvogeluar vlera, duke përfshirë natyrën dhe evidencën si bazë mbi të cilën drejtimi beson se do të rikuperohet vlera kontabël.

3. Përmbledhje e parimeve bazë kontabël (vazhdim)**3.8 Hua dhe paradhënie për klientët**

Huatë dhe paradhëniet për klientët paraqiten me vlerën e tyre neto me provigjionin për humbje specifike. Provigjionet janë krijuar në përputhje me politikat huadhënëse të Bankës e cila është në përputhje me ligjet në fuqi (Ligji për Bankat dhe Rregullorja e Bankës së Shqipërisë “Për Administrimin e Rrezikut të Kredisë” miratuar me Vendimin Nr. 52, datë 14 korrik 2004, ndryshuar me vendimin Nr. 26 datë 01.04.2015 të Këshillit Mbikqyrës së Bankës së Shqipërisë).

Rregullorja kërkon që Banka të klasifikojë kreditë në pesë kategori rreziku. Banka për secilën kategori rreziku aplikon normat e mëposhtme për krijimin e fondeve rezervë:

Tipi i huasë	Ditë vonesat	Fondi rezervë
Standarte	0-30 ditë	1-10% ¹
Në ndjekje	31-90 ditë	5-10% ²
Nën standarte	91-180 ditë	20%
E dyshimtë	181-365 ditë	50%
E humbur	Mbi 365 ditë	100%

Sipas ndryshimit të fundit të kësaj rregulloreje, në rastet kur kredia para ristrukturimit klasifikohet në kategorite “standarte” ose “në ndjekje” nëse ristrukturohet për herë të parë duhet të ruajë të njëjtën klasë dhe për të krijohen fonde rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë, me një normë jo më të vogël se 10 (dhjetë) për qind për kryegjënë dhe interesin.

Për ekspozimet të klasifikuara si “nën standarte” ose “e dyshimtë”, minimumi i fondit rezerve për humbje është 20% dhe 50% respektivisht.

Huatë dhe paradhëniet për klientët paraqiten me vlerën e tyre neto pasi zbritet provigjioni për humbje specifike nga huatë për kreditë e klasifikuara si nën-standarte, të dyshimta dhe të humbura. Rezerva për humbjet potenciale nga huatë e klasifikuara si “standarte” dhe “në ndjekje” regjistrohet në pasqyrën e bilancit si detyrim i Bankës.

3.9 Aktive të patrupëzura

Aktivet e patrupëzuara lidhen me programet informatike të blera, shpenzimet e nisjes së biznesit dhe marka tregtare që regjistrohen me koston e tyre historike dhe amortizohen për një periudhë pesë vjeçare, duke përdorur metodën lineare të amortizimit.

3.10 Aktive të trupëzura

Aktivet e trupëzuara paraqiten duke zbritur zhvlerësimin e akumuluar nga vlera e tyre bruto. Përlllogaritja e amortizimit bëhet me metodën lineare. Toka nuk zhvlerësohet. Normat vjetore të zhvlerësimin janë si më poshtë:

Kategoria	Norma vjetore
Makineri dhe pajisje	10 - 25%
Pajisje zyre	10 - 20%
Përmirësim i ambjenteve me qira	10 - 35%

Të ardhurat dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara paraqiten në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave të periudhës.

¹ Për krijimin e fondit rezervë mbi ekspozimet e ristruktuara Banka aplikon normën 10%, dhe minimumi 1% për kreditë “Standarte”

² Për krijimin e fondit rezervë mbi ekspozimet e ristruktuara Banka aplikon normën 10%, dhe minimumi 5% për kreditë “Në ndjekje”

3. Përmbledhje e parimeve bazë kontabël (vazhdim)

3.11 Të ardhura dhe shpenzime nga interesat

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së aktivit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme një periudhë më e shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të aktivit ose detyrimit financiar.

Për llogaritjen e normës efektive të interesit, Banka vlerëson flukset monetare të ardhshme duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra të cilat janë një pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

3.12 Të ardhura dhe shpenzime nga komisionet dhe tarifat

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet dhe tarifat rrjedhin nga shërbimet financiare që përfshijnë transfertat, aktivitetin huadhënës, komisionet për mbajtje llogarie, aktivitetin financiar tregtar dhe huadhënës. Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet dhe tarifat njihen kur shërbimi korrespondues është kryer apo përfituar.

3.13 Tatimi

Banka përcakton shumën e tatueshme në fund të vitit në përputhje me legjislacionin Shqiptar të tatimeve. Në vitin 2015, tatimi mbi fitimin është i barabartë me 15% (2014: 15%) të fitimit të tatueshëm. Fitimi i tatueshëm llogaritet duke modifikuar fitimin para tatimit për zëra të caktuar të ardhurash dhe shpenzimesh në përputhje me legjislacionin shqiptar. Fitimi përpara tatimit bazohet mbi regjistrimet financiare të mbajtura nga Banka për qëllime rregullatore në përputhje me MRF dhe mund të ndryshojë ndjeshëm nga rezultati financiar i raportuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"). Shiko shënimin 32. Për më tepër, MRF nuk kërkon që Banka të masë dhe të regjistrojë aktivet dhe detyrimet e shtyra.

Në përcaktimin e shumës së tatimit të vitit Banka merr në konsideratë efektin e disa pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse do ketë detyrime për tatime apo interesa shtesë. Banka beson se shpenzimet e saj të përlllogaritura për detyrime tatimore janë të përshtatshme për të gjithë vitet tatimore duke e bazuar vlerësimin e saj në shumë faktorë, përfshirë dhe interpretimin e legjislacionit tatimor dhe përvojat e mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë disa gjykime për ngjarje të ardhshme. Informacione të reja që mund të bëhen të ditura, mund të bëjnë që Banka të ndryshojë vlerësimin e saj për përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime do të ndikojnë shpenzimin tatimor në periudhën që bëhet përcaktimi.

3.14 Përdorimi i vlerësimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me Rregulloren e Bankës së Shqipërisë kërkon që Drejtimi të bëjë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, dhe paraqitjen e zërave jashtë pasqyrës së bilancit në datën e raportimit, dhe në shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së raportimit. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

BANKA NBG ALBANIA SH.A.**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015***(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, nëse nuk shprehet ndryshe)***4. Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore**

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Arka		
Në LEK	300,873	398,741
Në monedhë të huaj	1,009,063	837,140
Në ATM	119,205	115,622
Totali në Arkë	<u>1,429,141</u>	<u>1,351,503</u>
Banka Qëndrore		
Llogari rrjedhëse		
Në LEK	48,800	60,069
Në monedhë të huaj	1,066	842,304
Rezerva të detyrueshme		
Në LEK	1,064,191	1,313,489
Në monedhë të huaj	1,254,324	1,715,657
Totali në Bankën Qëndrore	<u>2,368,381</u>	<u>3,931,519</u>
Totali	<u><u>3,797,522</u></u>	<u><u>5,283,022</u></u>

Në përputhje me kërkesat e Bankës Qëndrore për rezervat e detyrueshme, Banka duhet të mbajë një minimum prej 10% të depozitave të klientëve në Bankën Qëndrore si llogari të rezervës. Rezerva e detyrueshme nuk është e vlefshme për veprimet ditore të Bankës.

Interesi mbi rezervat e detyrueshme në Bankën Qëndrore llogaritet me 70% të normës së marrëveshjeve të riblerjes (e cila ka qenë 1.75% në vit më 31 Dhjetor 2015, dhe 2.25% në vit më 31 Dhjetor 2014) mbi gjëndjen e depozitave të vendosura në LEK.

Me hyrjen në fuqi të vendimit Nr 28 datë 27.04.2011 “Për Miratimin e Normës së Interesit për Remunerimin e Rezervës së Detyruar të subjekteve Bankare” të Keshillit Mbikeqyrës së Bankës së Shqipërisë, rezervat e detyrueshme në Bankën Qëndrore mbi depozitat në valutë, nuk marrin remunerim. Për llogaritë rrjedhëse në Bankën Qëndrore nuk llogaritet interes.

5. Hua dhe paradhënie për institucionet e kreditit, neto

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Llogari rrjedhëse		
Jo-rezidentë	1,568,908	1,227,851
Rezidentë	11	11
	<u>1,568,919</u>	<u>1,227,862</u>
Depozita		
Jo-rezidentë	2,161,890	4,968,769
Rezidentë	114,492	-
Interesi i përlllogaritur	71	2,539
	<u>2,276,453</u>	<u>4,971,308</u>
Totali	<u><u>3,845,372</u></u>	<u><u>6,199,170</u></u>

Norma vjetore e interesit më 31 Dhjetor 2015 për depozitat me bankat jo-rezidente janë përkatësisht (-0.4%) në EUR dhe 0.45% në USD (gjate muajit Dhjetor 2014 normat e interesit kanë qenë përkatësisht 0.62% në EUR dhe 0.17% në USD).

BANKA NBG ALBANIA SH.A.**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015***(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, nëse nuk shprehet ndryshe)***5. Hua dhe paradhënie për institucionet e kreditit, neto (vazhdim)**

Llogaritë rrjedhëse që bankat korrespondente i detyrohen Bankës përfshijnë gjendjet me kompanitë simotra dhe me institucione të tjera të kreditit të cilat detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
<i>Anëtarët e grupit NBG</i>		
NBG- Zyra Qëndrore	33,953	343,114
NBG- Dega e Londrës	14,019	8,216
Totali për anëtarët e grupit NBG	47,972	351,330
<i>Bankat jo-rezidente</i>		
Deutsche Trust Bank	68,117	758,302
Intesa San Paolo Group	677,919	75,663
Atlantic Bank of Neë York	15,046	6,685
Commonëalth Bank of Australia	10,318	22,365
Deutsche Bank AG INTL	749,522	13,492
Standard Chartered Bank	14	14
Totali i bankave jo-rezidente	1,520,936	876,521
<i>Banka rezidente</i>		
Banka e Tiranës	11	11
Totali i bankave rezidente	11	11
Totali	1,568,919	1,227,862

Shuma e depozitave që Banka ka me kompanitë simotra dhe me institucionet e tjera të kreditit paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
<i>Anëtarët e grupit NBG</i>		
NBG Malta LTD	-	913,446
Totali për anëtarët e grupit NBG	-	913,446
<i>Bankat jo-rezidente</i>		
Erste Group Bank AG	880,557	806,618
KBC Bank NV Brussels	713,840	840,839
Unicredito Italiano	503,173	840,840
Raiffeisen International Bank AG	-	840,835
Intesa San Paolo	64,347	728,730
Totali i bankave jo-rezidente	2,161,917	4,057,862
<i>Bankat rezidente</i>		
Raiffeisen Bank	14,531	-
National Commercial Bank	100,005	-
Totali i bankave rezidente	114,536	-
Totali	2,276,453	4,971,308

BANKA NBG ALBANIA SH.A.**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015***(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, nëse nuk shprehet ndryshe)***6. Hua dhe paradhënie për klientët, neto**

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Hua dhe paradhënie për klientët, bruto	24,683,976	27,300,125
Provigjone për humbjet nga huatë	(3,564,975)	(8,459,438)
Totali	21,119,001	18,840,687

Provigjonet për humbjet nga huatë përfaqësojnë vetëm provigjonet për klasat e huave nën standarte, të dyshimta dhe të humbura siç grupohen në vazhdim të këtij shënimi. Provigjonet për kreditë standarte dhe në ndjekje klasifikohen bruto si detyrim (shënimi 14).

Lëvizjet në provigjone për huatë nënstandarte, të dyshimta dhe të humbura janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Gjendja më 1 janar	8,459,439	8,219,666
Kredi të fshira	(4,787,157)	-
Provigjone të vitit	1,208,697	956,288
Rimarrjet gjatë vitit	(1,273,638)	(722,551)
Efekti i kurseve të këmbimit	(42,365)	6,035
<i>Efekti i provigjonit në pasqyrën e të ardhurave</i>	<i>(107,306)</i>	<i>239,772</i>
Gjendja më 31 Dhjetor	3,564,976	8,459,438

Si pasojë e ndryshimeve në rregulloren Nr.62 të Bankës së Shqipërisë "Mbi menaxhimin e rrezikut të kredisë", më 01.04.2015, Bordi i Drejtorëve vendosi të fshijë nga librat e Bankës për qëllime rregullatore shumën e 4,787 milionë Lek gjatë 2015-ës (kreditë që ishin në klasën të humbura për më shumë se 3 vjet).

Klasifikimi i huave sipas kategorive është si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Standarte	16,954,192	14,826,420
Në ndjekje	2,787,137	2,685,621
Nënstandarte	1,314,786	687,747
Të dyshimta	586,522	1,414,306
Të humbura	2,836,212	7,529,593
Interesi i përllogaritur	205,127	156,438
Totali bruto	24,683,976	27,300,125

Klasifikimi i huave sipas industrive është si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Pasuri të patundshme	13,079,383	14,454,014
Industri	2,584,714	3,691,891
Tregti	3,696,086	3,511,461
Ndërtim	1,273,710	1,603,741
Personale	1,872,000	1,546,954
Bujqësi	23,162	82,031
Të tjera	1,949,794	2,253,596
Interesi i përllogaritur	205,127	156,437
Totali bruto	24,683,976	27,300,125

BANKA NGB ALBANIA SH.A.**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015***(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, nëse nuk shprehet ndryshe)***7. Letra me vlerë të vendosjes**

Letrat me vlerë të vendosjes përfshijnë bono thesari dhe detajohen si më poshtë:

Maturimi	31 Dhjetor 2015				
	Vlera nominale	Zbritje	Interes i përlllogaritur	Efekt negativ i Vlerës së Drejtë	Vlera kontabël
12 muaj LEK	2,160,330	(66,795)	39,208	-	2,132,743
1-5 vjet LEK	1,072,200	95	16,855	8,288	1,097,438
1-5 vjet EUR	1,098,240	(3,281)	10,235	-	1,105,194
>5 vjet LEK	849,999	(1,711)	10,516	(25,364)	833,440
Totali	5,180,769	(71,692)	76,814	(17,076)	5,168,815

Maturimi	31 Dhjetor 2014				
	Vlera nominale	Zbritje	Interes i përlllogaritur	Efekt negativ i Vlerës së Drejtë	Vlera kontabël
12 muaj LEK	3,559,110	(119,945)	79,357	(2,238)	3,516,284
12 muaj EUR	1,499,498	(9,257)	5,234	(942)	1,494,533
1-5 vjet LEK	250,000	-	4,244	(4,245)	249,999
1-5 vjet EUR	1,408,407	21,072	5,348	(236)	1,434,591
>5 vjet LEK	1,760,000	(1,996)	25,964	(30,450)	1,753,518
Totali	8,477,015	(110,126)	120,147	(38,111)	8,448,925

Tabela më poshtë paraqet minimumin dhe maksimumin e normave të interesit të aplikuara në letrat me vlerë të vendosjes gjatë vitit 2015 dhe 2014, sipas maturimit dhe monedhës së instrumentit:

Maturiteti	2015		2014	
	Minimumi i Normës së interesit	Maksimumi i Normës së interesit	Minimumi i Normës së interesit	Maksimumi i Normës së interesit
Bono Thesari LEK				
12 muaj	2.50%	3.60%	3.18%	3.87%
Obligacione qeveritare LEK				
1-5 vjet	4.90%	8.18%	4.74%	8.18%
> 5 vjet	4.55%	6.07%	4.74%	6.02%
Obligacione qeveritare EUR				
1-5 vjet	3.12%	5.75%	0.13%	4.43%

8. Letra me vlerë të mbajtura për tregtim

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Obligacione qeveritare	-	50,000
Interesi i përlllogaritur	-	1,037
Totali	-	51,037

BANKA NBG ALBANIA SH.A.**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015***(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, nëse nuk shprehet ndryshe)***9. Aktive të patrupëzuara, neto**

	Programe informatike	Të tjera	Totali
Kosto			
Më 1 janar 2014	341,864	8,114	349,978
Shtesa	25,868	-	25,868
Më 31 Dhjetor 2014	367,732	8,114	375,846
Shtesa	32,366	-	32,366
Më 31 Dhjetor 2015	400,098	8,114	408,212
Amortizimi i akumuluar			
Më 1 janar 2014	318,535	7,527	326,062
Shpenzimi i vitit	11,769	405	12,174
Më 31 Dhjetor 2014	330,304	7,932	338,236
Shpenzimi i vitit	13,858	180	14,038
Më 31 Dhjetor 2015	344,162	8,112	352,274
Vlera kontabël neto			
Më 1 Janar 2014	23,329	587	23,196
Më 31 Dhjetor 2014	37,428	182	37,610
Më 31 Dhjetor 2015	55,936	2	55,938

Aktivitet e patrupëzuara përbëhen nga programe informatike software dhe në zërin “të tjera” është përfshirë licenca nga VISA International.

BANKA NGB ALBANIA SH.A.**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015***(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, nëse nuk shprehet ndryshe)***10. Aktive të trupëzuara, neto**

	Makineri dhe pajisje	Mobilje dhe pajisje zyre	Aktive në proces	Totali
Kosto				
Më 1 janar 2014	599,849	400,774	1,674	1,002,297
Shtesa	13,286	2,795	5,670	21,751
Transferta	-	1,229	(1,229)	-
Nxjerrje Jashtë Përdorimit	(1,118)	-	-	(1,118)
Më 31 Dhjetor 2014	612,017	404,798	6,115	1,022,930
Shtesa	15,351	10,237	2,430	28,018
Nxjerrje Jashtë Përdorimi	-	(1,524)	-	(1,524)
Më 31 Dhjetor 2015	627,368	413,511	8,545	1,049,424
Zhvlerësim i akumuluar				
Më 1 janar 2014	544,498	327,165	-	871,663
Shpenzimi i vitit	20,351	21,306	-	41,657
Nxjerrje Jashtë Përdorimi	(1,118)	-	-	(1,118)
Më 31 Dhjetor 2014	563,731	348,471	-	912,202
Shpenzimi i vitit	18,358	20,439	-	38,797
Nxjerrje Jashtë Përdorimi	-	(900)	-	(900)
Më 31 Dhjetor 2015	582,089	368,010	-	950,099
Vlera kontabël neto				
Më 1 Janar 2014	55,351	73,609	1,674	130,634
Më 31 Dhjetor 2014	48,286	56,327	6,115	110,728
Më 31 Dhjetor 2015	45,279	45,501	8,545	99,325

11. Aktive të tjera

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Tatim fitimi i parapaguar	117,734	140,575
Përmirësimi i ambjenteve me qira	83,316	88,930
Debitorë	64,111	269,020
